



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT**

Nr. 492 Prot.

Patos, më 19/02 /2024



**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
**Fation Duro**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 15, datë 19/02 /2024

**MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR RIKONSTRUKSION BANESASH**  
**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Bazuar në pikën 2 dhe 3 të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 5 i ligjit nr. 9232, dt.13.05.2004, “Për Programet Sociale për Strehim të Banorëve të Zonave Urbane” i ndryshuar, nenit 14, pika 2 dhe 3 të nenit 15, nenit 16, 34, 39 e 73 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, V.K.M. nr. 574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore” si dhe V.K.M nr. 1093, datë 28.12.2015 “Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparsive për dhënien e bonusit të strehimit”, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e tabelës së pikëzimit sipas formatit të paraqitur.
2. Tabela e pikëzimit është pjesë e këtij projektvendimi.

**Anëtarët e Programit të Strehimit Social**

**1. Boreta Murati**

**2. Anisa Kripa**

**3. Fabjola Dervishaj**

**4. Grisilda Bektashi**

**5. Edona Beqaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**Sistemi i pikëzimit për programin “Rikonstruksioni i banesave për familjet në nevojë”.**

**TABELA**

<b>Nr.</b>	<b>Kriteret e pikëzimit</b>	<b>Pikët sipas tabelës</b>	<b>Vlerësimi i komisionit</b>
<b>1.</b>	<b>Kushtet e strehimit</b>	<b>30</b>	
	Banojnë në banesa amortizuara pronë e tyre (çertifikatë)		<b>4</b>
	Viti i ndërtimit të banesës pas 1990		<b>1</b>
	Viti i ndërtimit të banesës 1970 - 1990		<b>4</b>
	Viti i ndërtimit të banesës 1950 - 1970		<b>10</b>
	Viti i ndërtimit të banesës para 1950		<b>11</b>
<b>2.</b>	<b>Kushtet familjare</b>	<b>20</b>	
	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë.		<b>7</b>
	Familjet me më shumë se 2 fëmijë.		<b>4</b>
	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për tu strehuar në institucionet publike të perkujdesit shoqëror.		<b>5</b>
	Çifte të reja me moshë totale deri në 70 vjeç.		<b>4</b>
<b>3.</b>	<b>Kushtet sociale</b>	<b>20</b>	
	Në përbërje të familjes të kenë persona me aftësi të kufizuar.		<b>5</b>
	Persona me statusin e jetimit.		<b>6</b>
	Viktima të dhunës në familje.		<b>3</b>
	Komuniteti romë dhe egjiptian.		<b>6</b>
<b>4.</b>	<b>Kushtet ekonomike</b>	<b>30</b>	
	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare.		<b>14</b>
	Të ardhura deri 80% - 100% të të ardhurave mesatare.		<b>10</b>
	Të ardhura 100% - 120% të të ardhurave mesatare.		<b>6</b>
	<b>TOTAL I PIKËVE</b>	<b>100</b>	

**Anëtarët e Programit të strehimit social**

1. Boreta Murati

2. Anisa Kripa

3. Fabjola Deryishaj

4. Grisilda Bektashi

5. Edona Beqaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT**

Nr. 497 / Prot.

Patos, më 19/02 /2024

**RELACION**  
**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR RIKONSTRUKSION BANESASH**

Të nderuar Këshilltar !

Tabela e pikëzimit paraqitur sot në K/Bashkiak nga ekipi i menaxhimit është bazuar në pikën 2 dhe 3 të nenit 24, shkronjës “e” të nenit 54 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 5 i ligjit nr. 9232, dt.13.05.2004, “Për Programet Sociale për Strehim të Banorëve të Zonave Urbane” i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar si dhe V.K.M. nr. 574, datë 29.08.2012. “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit”, ekipi i menaxhimit në mbledhjen e radhës pasi shqyrtoi dhe verifikoi në terren kërkesat e paraqitura, problematikën e tyre, si dhe kushtet për këto objekte, vendosi në përfundim të mbledhjes këtë sistem pikëzimi që po ju paraqit. Për bashki të ndryshme specifikat për tu trajtuar me programin e strehimit janë të ndryshme në varësi të rasteve.

Tabela ndahet në katër pika kryesore.

**Kushtet e strehimit, kushtet familjare, kushtet sociale, kushtet ekonomike.**

**Për kushtet e strehimit** – është patur parasysh tu jepet përparësi familjeve të cilat posedojnë një banesë për strehim në pronësi dhe përparësi të kenë banesat me moshë të hershme.

**Për kushtet familjare** – është patur parasysh fakti që familjet një prindërorë dhe ato familje që kanë më shumë se 2 (dy) fëmijë të kenë përparësi dhe janë vlerësuar me nga 6 (gjashtë) pikë secila.

**Për kushtet sociale**- ju është dhënë përparësi familjeve me status jetimi persona me aftësi të kufizuar dhe familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

**Për kushtet ekonomike**- është marrë parasysh dhe gjendja ekonomike e familjes, ku përparësi ju është dhënë familjeve me të ardhura të pakëta.

**Anëtarët e Programit të Strehimit Social**

1. Boreta Murati

2. Anisa Kripa

3. Fabjola Dervishaj

4. Grisilda Bektashi

5. Edona Beqaj

6. Shkëlqim Beqiraj

